

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

**Për Aktivitetin e Prokurimit:**

Nr <sup>1</sup> i prokurimit	207-24-8996-5-1-1
Nr i brendshëm	207-24-079-5-1-1

Sa i përket tenderit për: "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen [ri-konfigurimin] e Stadiumit në Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA"

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Raf II SHPK**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Xhelal Hajda-Toni**

(Adresa)

**Rahovec**

**21000**

(Vendi)

(Kodi postar)

**+383 44 506 037**

**N/A**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Haxhi Bytyçi**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[rafiipr@yahoo.com](mailto:rafiipr@yahoo.com)

(Adresa elektronike)

**01.04.2025**

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## **2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

*(Adresa e plotë)*

*(Numri i Telefonit)*

*(Numri i faks-it)*

*(Adresa elektronike)*

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

## **3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Njoftimi për Kontratë: 02.09.2024

Data e hapjes së ofertave: 02.12.2024

Njoftimi mbi vendimin:13.03.2025

Kërkesa për rishqyrtim:18.03.2025

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:20.03.2025

## **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 10 i LPP-së  
Neni 11 i LPP-së  
Neni 52 i LPP-së  
Neni 56 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 65 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 72 i LPP-së  
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.13.03.2025, ku është rekomanduar për kontratë OE BM Group SH.P.K, ndërsa ne jemi eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Me datë 20.01.2025 jemi njoftuar nga KRPP / HELPDESK I Prokurimit; që ofertat e OE të lartë cekur nuk hapen dhe kane paraqitur arsyet:

Ne aktivitetin e prokurimit me Nr. 207-24-8996-5-1-1 perdoruesi i OE Raf II (Haxhi Bytyqi) ka filluar pergaditjen e ofertes me date 22.10.2024 dhe kohe 08:19min, ndersa perdoruesi Grup i Operatorëve Ekonomik ALBA GROUP SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P.K ( Sherif Ramuka) ka filluar pergaditjen e ofertes me date 21.10.2024 dhe kohe 18:37min - Me date 22.10.2024 dhe kohe 11: 16 min, ju si AK keni derguar aktivitetin e prokurimit ne "Apel" - Me date 02.12.2024 11:18 dhe kohe 11:18 min perdoruesi i OE Raf II (Haxhi Bytyqi) ka vazhduar me pergaditjen e ofertes se filluar me date 22.10.2024, ka krijuar formularin ee dorezimit te ofertes dhe ka dorezuar oferten me date 02.12.2024 dhe kohe 11:27. - Me date 02.12.2024 dhe kohe 10:04 min perdoruesi i Grup i Operatorëve Ekonomik ALBA GROUP SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P. K (Sherif Ramuka) ka vazhduar me pergaditjen e ofertes se filluar me date 21.10.2024, ka krijuar formularin e dorezimit te ofertes dhe ka dorezuar oferten me date 02.12.2024 dhe kohe 10:07min.

Pra, arsyeja se pse nuk shkarkohet oferta e OE „Raf II”sh.p.k. dhe oferta e Grup i Operatorëve Ekonomik ALBA GROUP SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P.K.; DAJTING SH.P.K, nga pjesa/folderi ofertat, eshte sepse cdo dokument i ofertave perkatese i cili eshte ngarkuar para se procedura te dergohet ne apel me date 22.10.2024 eshte kriptuar me çelesat paraprak dhe nuk dekriptohen me çelesat e fundit te krijuar per procedure dhe te cilet jane krijuar me date 19.11.2024 nga ana e AK. Per informimin tuaj, per t’a konfirmuar kete kronologji, ju mund t’i referoheni te dheneve nga “permbledhja e prokurimit” ne kuader te detajeve te procedures. Per t’a verifikuar se cilet nga dokumentet e ofertave hapen me çelesat e fundit (dokumentet e ngarkuara me date 02.12.2024 apo pas heqjes se procedures nga apeli), ju mund t’a beni kete ne hapin perkates gjate procesit te hapjes ose vleresimit te ofertave. Me respekt! HelpDesk +381 038 200 82 000 <https://e-prokurimi.rks-gov.net> Departamenti i Teknologjisë Informativë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Kjo arsye e eliminimit është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme, madje për neve është shumë e habitshme se si nuk janë hapur dokumentet të cilat janë ngarkuar në mënyrë të rregullt. Fillimisht sqarojmë se me dt.22.10.2024 kur ka qenë afati i fundit për ofertim ne kemi vendosur në sistem tërë dokumentacionin tjetër dhe kemi pritur që ndërkohë ta ngarkojmë edhe paramasën, mirëpo ndërkohë është pezulluar aktiviteti i prokurimit për shkak të një ankese, ku procedura është dërguar në apel. Më pastaj me dt.02.12.2024 ne kemi vazhduar procedurën e dorëzimit të ofertës aty ku kishte mbetur dhe kemi bashkangjitur edhe paramasën dhe kemi ofertuar. Në këtë mënyrë ne edhe shumë herë të tjera ofertojmë dhe asnjëherë nuk kemi pas ndonjë vërejtje që nuk po hapet oferta, prandaj edhe në këtë rast normalisht nuk duhet të ndodh një gjë e tillë.

Mënyra e ofertimit është e rregullt dhe ne nuk duhet të pësojmë për arsye të tjera teknike ose që nuk varen nga ne.

Asnjë njoftim, asnjëherë nuk ka ekzistuar se nuk lejohet të vazhdohet ofertimi aty ku ka mbetur dhe se nuk mund të hapen ofertat nëse ofertohej në këtë mënyrë, prandaj ne nuk duhet të pësojmë për ndonjë arsye teknike dhe për ndonjë përgjegjësi të AK-së apo KRPP-së.

**Ne me dt.14.03.2025 kemi kërkuar qasje në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa na është mundësuar të shkojmë në qasje me dt.17.03.2025 por që qasja nuk na është lejuar e plotë për shkak se OE i rekomanduar për kontratë e plotësuar aneksin 3 për sekret afarist.**

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka plotësuar aneksin 3 për sekret afarist, mirëpo në asnjë mënyrë nuk ka arsyetuar kërkesën për sekret afarist por vetëm e ka cekur se dokumentet e nenit 68 dhe 69 nuk janë pronë publike.

Sipas nenit 11 paragrafi 3 të LPP-së, kërkesa duhet të arsyetohet dhe të parashtrohen arsye konkrete, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të grupit të operatorëve ekonomik.

OE i rekomanduar për kontratë, nuk ka dhënë ndonjë dëshmi apo arsye se qasja në dokumente do të dëmtonte interesat materiale dhe komerciale të tij, prandaj kjo deklaratë e tij nuk mund të merret parasysh sepse nuk është konform kërkesave ligjore.

Ju sqarojmë se autoriteti kontraktues duhet të klasifikojë si sekret afarist informatat dhe dokumentet nëse janë përmbushur tri kriteret e përmendura në nenin 11.3 të LPP-së.

Në lidhje me qasjen në dokumente dhe sekretin afarist edhe KRPP ka lëshuar interpretimin e dt.24.10.2024 tek pyetja nr.31, e ku ceken qartë tri kriteret e përmendura në nenin 11.3 të LPP-së, si në vijim

Në përputhje me paragrafin 3 të nenit 11 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues mund t'i klasifikojë informatat tjera si informata sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere (kushte):

1.1 “që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

1.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikuljt e tillë si sekret; dhe

1.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik”.

Në rastin konkret nuk janë përmbushur tri kushtet e nenit 11.3 të LPP-së.

Në interpretimin e lartcekur të KRPP-së, shënohet ndër të tjera si më poshtë:

7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

a. Informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe

b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-konfidenciale vetëm nëse:

a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon (“markon”) dokumentet si “sekret afarist” gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit “Kërkesa për sekret afarist”.

b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 “Kërkesa për sekret afarist”, të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si “sekret afarist”, nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.

Në këtë tender OE i rekomanduar për kontratë nuk ka markuar dokumentet si sekret afarist, e as që i ka arsyetuar, prandaj autoritet kontraktues ka bërë shkelje ligjore të nenit 10 duke mos na lejuar qasje në dokumentet e këtij grupi të OE.

Autoritet kontraktues nuk i ka zbatuar dispozitat e lartcekura të LPP-së dhe po ashtu nuk e ka përgatitur versionin e pastruar sipas nenit 11.4 të LPP-së dhe këtë veprim nuk e ka ndërmarr me qëllim për të favorizuar grupin e operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-081 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE.

Në mungesë të lejitimit të qasjes për OE e rekomanduar për kontratë ne kemi parashtruar pretendimet tona ankimore duke pasur njohuri nga tenderët paraprak dhe me dyshimet që ne i kemi për dokumentet e këtij OE.

- OE i rekomanduar për kontratë ka borxhe në ATK dhe ka marrëveshje për pagesë të borxhit, prandaj duhet të eliminohet nga konkurrenca. Kërkojmë që të analizohen dokumentin e ATK-së.

Sipas nenit 65 par. 4.8 të LPP-së nëse një OE nuk ka të paguar ndonjë tatim në vendin e themelimit nuk i lejohej të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit, prandaj në këtë rast edhe ky OE është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

- Tek neni 8.1&8.2 i FDT-së është kërkuar:

**Kërkesa 1.2. Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se disponon me kapital të mjaftueshëm për zbatimin e kontratës, qofte mjete të gatshme në llogarinë bankare OSE qasje në një kredi bankare, të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, përkatësisht në emër të këtij aktiviteti të prokurimit, në shumën 2,000,000.00 € [Dy milion euro].**

**Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2. Një [1] vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik,**

disponon me mjete të gatshme në llogarinë bankare, në shumën 2,000,000.00 € [Dy milion euro]. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] Një [1] kopje e origjinalit. OSE Një [1] vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon me qasje në një kredi bankare të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, në shumën 2,000,000.00 € [Dy milion euro]. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] Një [1] kopje e origjinalit.

OE i rekomanduar për kontratë dyshojmë që nuk e ka plotësuar këtë kërkesë, sepse nuk ka mundësi të ketë në bankë vlerën e kërkuar. Po ashtu nëse ka ofruar vërtetim për kredi dyshojmë se nuk e ka ofruar dëshminë sipas kërkesës, pra nuk ka ofruar vërtetim për qasje në kredi të pakushtëzuar në vlerën 2, 000,000.00 €. Zakonisht edhe në tender të tjerë nuk e ka ofruar vërtetimin për qasje në kredi të pakushtëzuar.

- Në nenin 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar:

**Kërkesa 1.3. Operatori ekonomik** Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për punë ndërtimore për zbatimin e projekteve të hollësishme [zbatuese kryesore]- të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e ndërtesave publike shoqërore [sipas kuptimit të paraqitur në vijim] , në shumën prej 15,000,000.00 € [Pesëmbëdhjetë milion euro].

**Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.3. - Operatori ekonomik** Grupi i operatorëve ekonomik, duhet të dorëzoj dokumentacionin si në vijim -

'Kontratat dhe Raportet e pranimit teknik të punëve', të lëshuara nga autoritetet kontraktuese, publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave projekteve përkatëse [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] - Një [1] kopje e origjinalit. OSE - 'Certifikatat Referencat e përfundimit të punëve', të lëshuara nga autoritetet kontraktuese, publike ose private, të cilat vërtetojnë kontraktimin dhe zbatimin e kontratave projekteve përkatëse [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] - Një [1] kopje e origjinalit. **Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 3. - Për të gjitha kontratat projektet e deklaruar, Operatori ekonomik** Grupi i operatorëve ekonomik, duhet të plotësoj në tërësi Tabelën nr. 1, si dhe të njëjtës duhet të ia bashkëngjisë fotografitë e punëve të zbatuara, në jo më tepër se në katër [4] faqe [bashkërisht me Tabelën nr. 1] me madhësi A4 - Një [1] kopje e origjinalit. **Sqarim i përkufizimit [Ndërtesat publike shoqërore]** - Ndërtesat publike shoqërore, në rastin e kësaj lënde aktiviteti të prokurimit, nënkupton dhe përfshinë të gjitha tipologjitë e ndërtesave të sportit, të kulturës, të arsimit, të shëndetësisë, të administratës [nën-administrim pronësi shtetërore- lokale qendrore (brenda dhe jashtë Kosovës), nën-administrim pronësi të shteteve të tjera ose të organizatave ndërkombëtare (brenda dhe jashtë Kosovës)], të gjitha tipologjitë e ndërtesave të shërbimeve dhe tregtare [nën-administrim pronësi private], të gjitha tipologjitë e ndërtesave të banimit shumëkatesh, si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera funksionale [nën-administrim pronësi private] dhe të gjitha tipologjitë e ndërtesave të industrisë dhe të magazinimit; ndërsa përjashton të gjitha tipologjitë e infrastrukturës së transportit dhe teknike dhe të tjerave të ngjashme [duke mos pasur parasysh formën e administrimit pronësisë], si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera hapësinore funksionale.

Dyshojmë që OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë sepse nga tenderët e kaluar kemi vërejtur se ky OE ka kontrata për furnizime më shumë se sa

kontrata të ndërtimit. Pra ky OE nuk ka ofruar dëshmi për realizmin e kontratave të ndërtimit, arkitekturës dhe të inxhinierisë, ndërtim të ndërtesave publike shoqërore në shumën **15,000,000.00 €**, prandaj është i papërgjegjshëm.

- **Më poshtë po i kontestojmë kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontratë, e të cilët dokumente ne i kemi pranuar me qasje në tenderin me titull “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK” MINISTRIA E SHËNDETËSISË. Mendojmë se të gjitha këto kontrata janë të bashkangjitura edhe në këtë projekt.**
- Referenca e lëshuar nga **Bau Holding L.L.C** në vlerë prej 1,435,818.68 €, e ku shënohet se ka përfunduar pjesërisht ndërtimin e stadionit të Gjilanit.  
Kjo referencë është dashur të verifikohet se a janë kryer punë të ndërtimit apo janë bërë vetëm furnizime me beton apo diçka tjetër. Verifikimi është dashur të bëhet edhe përmes transaksioneve bankare.
- Referencë nga **Parking Center** në vlerë prej 1,313,564.01 €, e ku shënohet se kanë nënshkruar kontratë për ekzekutimin e punimeve (furnizim dhe punë).  
Kjo referencë është dashur të verifikohet se a janë kryer punë të ndërtimit apo janë bërë vetëm furnizime me beton apo diçka tjetër. Verifikimi është dashur të bëhet edhe përmes transaksioneve bankare.
- Referencë nga **Pozhegu Brothers** në vlerë prej 535,694.00 €, e ku shënohet se me sukses pjesërisht ka përfunduar **furnizimin me beton** për ndërtimin e objektit afarist banesor Garden Building-C5 dhe Sofali.  
Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime. Kjo vërtetohet edhe tek kontrata e prezantuar ndërmjet tyre.
- Referencë nga **Ip Kos SHPK** në vlerë prej 624,107.21 €, e ku shënohet se ka përfunduar **furnizimin me beton** dhe punimin e pompës.  
Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime.
- Referencë nga **Britania Homes SHPK** në vlerë prej 922,353.22 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses **furnizimin dhe për ndërtimin** e objekteve në lagjen Britania Homes.  
Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse ka të bëjë me furnizime.
- Referencë nga **Marigona Hill SHPK** në vlerë prej 838,593.00 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses furnizimin dhe për ndërtimin e objekteve në lagjen Britania Homes.  
Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime.
- Referencë nga **Mada Group SHPK** në vlerë prej 4,364,743.74 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses **furnizimin dhe për ndërtimin** e objekteve në lagjen MARIGONA Hill.  
Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime.

- Referencë nga **Bau Holding LLC** në vlerë prej 6,268,653.31 € për punime në parkun industrial, mirëpo kjo kontratë duhet të verifikohet se a është realizuar për ndërtim të lartë dhe kjo duhet të bëhet duke analizuar transaksionet se a janë bërë pagesat dhe nëse ka pagesa, a janë bërë për ndërtim të lartë apo për furnizime. Kontrata e nënshkruar ceket se ka të **bëjë me furnizimin** dhe kryerjen e punimeve. Kjo referencë nuk duhet të merret parasysh.
- Referencë nga **R&Rukolli SHPK** në vlerë prej 637,475.00 €, e ku shënohet se ka përfunduar punë si: instalime elektrike dhe nxemje qendrore. Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes sepse ka të bëjë me punë elektrike, kjo vërtetohet edhe nga kontrata e prezantuar.
- Referencë nga **Viva Fresh Store** në vlerë prej 1,044,995.15 €, e ku nuk përputhet përshkrimi i bërë tek referenca me atë tek kontrata, sepse në kontratë titulli është kontratë për furnizim dhe shërbime. Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Edhe kontratat me **UNOPS** nuk janë shumë të qarta dhe nuk shihet që kanë të bëjnë me ndërtim por kanë të bëjnë me furnizime, si me boca oksigjeni e të ndryshme, prandaj kërkojmë që të verifikohen se a kanë të bëjnë me ndërtim të lartë, sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Të gjitha kontratat e cekura nuk mund të merren parasysh, sepse për disa po është shumë e qartë se kanë të bëjnë me **furnizime**, ndërsa për disa të tjera ku nuk janë qartësuar të dhënat, të paktën është dashur të verifikohen se a kanë të bëjnë me ndërtim të lartë dhe a ekzistojnë transaksionet ndërmjet tyre për ndërtim të lartë.

- Referenca e lëshuar nga UNOPS për ndërtimin e Fakultetit të Matematikës dhe shkencave Natyrore është lëshuar me dt.14.02.2024 ndërsa në brendi shkruan se janë përfunduar 85 % e punëve të kontraktuara, prandaj kjo kontratë dhe referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit që kontratat të jenë të përfunduara.

Nëse analizohet në detaje, lista e kontratave të OE të rekomanduar për kontratë dhe referencat për punë sipas kërkesave të dosjes së tenderit, rezulton se ky OE i ka **12,915.0006.20 €** punë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj është i papërgjegjshëm

Autoriteti kontraktues është dashur të shfrytëzojë nenin 52.7 të LPP-së për të bërë një kontrollim efektiv të informatave dhe dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë për kontratat të cilat nuk janë shumë të qarta, edhe pse në asnjë variant ky OE nuk e plotëson kërkesën për të dëshmuar vlerën e kontratave në vlerë prej së **paku 15 milion euro.**

**Të gjithë OE tjerë ofertues janë të papërgjegjshëm dhe të gjitha arsyet e eliminimit të këtyre OE ofertues që janë dhënë nga AK-së janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj më poshtë vetëm po i cekim arsyet e dhëna të eliminimit nga AK-së për secilin ofertues.**

Grup i Operatorëve Ekonomik Pepa Group; CONEX L.L.C.; Agri Construction  
shpkAutostrada Tirane Dures, Km0, Zk 2679, Nr.pas 121/13, Tirane

12,282,015.00 €

**ARSYETIM I ELIMINIMIT:**

Grup i Operatorëve Ekonomik Pepa Group; CONEX L.L.C.; Agri Construction shpk: nuk e plotëson kriterin për referenca mbi 15,000,000.00 Euro pasi që te njëjtut bazuar ne Dokumentacionin e bashkangjitur kane paraqitur listën (sipas aneksit 1) ne vlere financiare 19309660.04 Euro mirëpo që projekti ne vlere financiare 3921776.29 dhe projekti ne vlerë financiare 886859.75 Euro janë realizuar ose kane pranim ne Tetor 2024 ndërsa procedura është hapur me date 29.08.2024 dy muaj para këtij pranimi. Dihet se përmes LPP dhe Rregulloreve (Referencat kane te bëjnë me datën para publikimit te Njoftimit për Kontratë). Shtoja kësaj se GOE nuk e arrijnë 60% e vlerës se Liderit pasi që 60% e vlerës 15 milionë është 9 milionë euro ndërsa kompania ka vetëm 8.98 milionë Euro.

Grup i Operatorëve Ekonomik EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.; Ed Konstruksion shpk; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.Tirane Kamez KAMEZ Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit, Tiranë	13,472,612.42 €
--	-----------------

**ARSYETIM I ELIMINIMIT:**

1. Sigurimi i tenderit nga ana e Autoritetit Kontraktues është kërkuar ne vlerën financiare 300,000.00 Euro / GOE ka paraqitur sigurimin e tenderit vetëm në vlerën financiare 6000.00 Euro.
2. Nuk e plotëson Kriterin që disponon me kapital të mjaftueshëm për zbatimin e kontratës, qofte mjete të gatshme në llogarinë bankare OSE qasje në një kredi bankare, të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, përkatësisht në emër të këtij aktiviteti të prokurimit, në shumën 2,000,000.00 € [Dy milion euro]. Pasi që i njëjti nuk e ka të aprovuar këtë kriter.
3. I mungon Tabela 1 / të aspekti i referencave (I njëjti e ka bashkangjitur vetëm aneksin 1) mirëpo jo te plotësuar sipas kërkesës nga AK.

Grup i Operatorëve Ekonomik ALBA GROUP SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH P K · DAITING SH.P.K.Robert Doll, PRISHTINË	13,793,752.00
--	---------------

**ARSYETIM I ELIMINIMIT:**

Me datë 20.01.2025 jemi njoftuar nga KRPP / HELPDESK I Prokurimit; që ofertat e OE të lartë cekur nuk hapen dhe kane paraqitur arsyet:

Ne aktivitetin e prokurimit me Nr. 207-24-8996-5-1-1 perdoruesi i OE Raf II (Haxhi Bytyqi) ka filluar pergaditjen e ofertes me date 22.10.2024 dhe kohe 08:19min, ndersa perdoruesi Grup i Operatorëve Ekonomik ALBA GROUP SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P.K ( Sherif Ramuka) ka filluar pergaditjen e ofertes me date 21.10.2024 dhe kohe 18:37min - Me date 22.10.2024 dhe kohe 11: 16 min, ju si AK keni derguar aktivitetin e prokurimit ne "Apel" - Me date 02.12.2024 11:18 dhe kohe 11:18 min perdoruesi i OE Raf II (Haxhi Bytyqi) ka vazhduar me pergaditjen e ofertes se filluar me date 22.10.2024, ka krijuar formularin ee dorezimit te ofertes dhe ka dorezuar oferten me date 02.12.2024 dhe kohe 11:27. - Me date 02.12.2024 dhe kohe 10:04 min perdoruesi i Grup i Operatorëve Ekonomik ALBA GROUP SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P. K (Sherif Ramuka) ka vazhduar me pergaditjen e ofertes se filluar me date 21.10.2024, ka krijuar formularin e dorezimit te ofertes dhe ka dorezuar oferten me date 02.12.2024 dhe kohe 10:07min.

Pra, arsyeja se pse nuk shkarkohet oferta e OE „Raf II“sh.p.k. dhe oferta e Grup i Operatorëve Ekonomik ALBA GROUP SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P.K.; DAJTING SH.P.K, nga pjesa/folderi ofertat, eshte sepse cdo dokument i ofertave perkatese i cili eshte ngarkuar para se procedura te dergohet ne apel me date 22.10.2024 eshte kriptuar me çelesat paraprak dhe nuk dekriptohen me çelesat e fundit te krijuar per procedure dhe te cilet jane krijuar me date 19.11.2024 nga ana e AK. Per informimin tuaj, per t'a konfirmuar kete kronologji, ju mund t'i referoheni te dhenave nga "permbledhja e prokurimit" ne kuader te detajeve te procedures. Per t'a verifikuar se cilet nga dokumentet e ofertave hapen me çelesat e fundit (dokumentet e ngarkuara me date 02.12.2024 apo pas heqjes se procedures nga apeli), ju mund t'a beni kete ne hapin perkates gjate procesit te hapjes ose vleresimit te ofertave. Me respekt! HelpDesk +381 038 200 82 000 <https://e-prokurimi.rks-gov.net> Departamenti i Teknologjisë Informative Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Të bashkangjitura me raport janë të gjitha detajet lidhur me shkresat e KRPP-se dhe Zyres së Prokurimit.

E njëjta nuk e ka vazhduar Validitetin e Ofertave sipas Kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Grup i Operatorëve Ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË;  
Roza Komani B.I.Rr. Tringe Smajli 16/7, Prishtine

14,245,178.00

**ARSYETIM I ELIMINIMIT:**

1. Grup i Operatorëve Ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; Roza Komani B.I.: ka aplikuar me PEVLAKU – Dega ne Kosovë dhe bazuar ne raportet e auditimit nga kjo kompani vlerë financiare e realizuar për 3 vitet e fundit (gjithmonë duke u bazuar ne raportet e auditimit) kap vlerë financiare 11978320 Euro (ndërsa AK ka kërkuar qe Lideri te arrije qarkullimin financiar se paku 1 milionë Euro) apo me mire te themi 60% te vlerës totale te kërkuar 20 milionë euro. Po ashtu ky Grup operatorëve kur plotësojnë njeri tjetrin vlere totale e referencave te paraqitura eshte 15524977.00 Euro ndërsa AK ka kërkuar qarkullim financiar 20 milionë Euro, për rreth 4.5 milionë euro nuk arrihet te paraqitet kjo vlere.

2. Deklarata e paraqitur nga Credins Bank ne Kosovë thekson se mund ta financojmë kërkesën Autoritetit / mirëpo qe i njëjti nuk e ka te aprovar si kërkesë.

3. GOE Pevlaku dhe Roza Komani BI kane paraqitur referenca te natyrës se ngjashme ne vlere financiare 14352095 Euro pasi qe projekti me numër 2 të PEVLAKU është i datës 29.03.2021 (3 vite me shume se sa afati kohor i lejuar me LPP), po ashtu te OE Roza Komani BI theksohet qe projekti me numër 3 është Rregullim i Urës qe nuk ka te beje asgjë me natyrën e kontratës sonë dhe se projekti me numër 1 është ende ne zbatim (pra ka paraqitur reference te pjesshme).

ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.ARBËRI NORA E HOTIT,BLL.C2-  
10,OBJ."B"HI-4/2, PRISHTINË 810794215

14,438,808.0

**ARSYETIM I ELIMINIMIT:**

Operatori Ekonomik ADA CONSULTING GROUP SHPK nuk e ploteson kriterin - Kërkesa 1.3. Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për punë ndërtimore për zbatimin e projekteve të hollësishme [zbatuese kryesore]- të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e ndërtesave publike shoqërore [sipas kuptimit të paraqitur në vijim] , në shumën prej 15,000,000.00 € [Pesëmbëdhjetë milion euro]. Pasi që i njëjti bazuar në dokumentacionin e bashkangjitur dhe tabelen e hartuar nga ana e tij i ka paraqitur projektet në zbatim dhe ato që janë zbatuar për gjatë tre viteve të shkuara dhe të cilët nuk e plotesojnë kriterin prej 15 miliona Euro / pasi që i njëjti ne të gjitha projektet ka pranime të pjesshme dhe jo vlerën totale.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Vlera financiare 2021-2023	Referencat që pranohen	Detajet:
1	Ministria e Administratës Publike	115,332.32 €		E përfunduar 05.01.2021 (me shumë se tre vite) / pranimi me datë 10.12.2020.
2	QKUK	254,830.00 €		E përfunduar me datë 27.08.2021 (me shumë se tre vite nga data e publikimit).
3	Ada Consulting Group	2,024,817.23 €	2,024,818.23 €	Pranohet në teresi
4	Ada Consulting Group	1,713,337.23 €	1,713,337.23 €	Pranohet në teresi
5	Ministria e Administratës Publike	3,990,786.46 €		Referenca me datë 18.09.2024 (pas publikimit)
6	Millennium Foundation Kosovo	692,361.20 €	692,361.20 €	Pranohet në teresi
7	QKUK	1,832,019.88 €	1,832,019.88 €	Pranohet në teresi
8	Ada Consulting Group	6,739,997.09 €		Nuk pranohet Certifikat e përdorimit 15.10.2024 pas Njoftimit për Kontratë.
9	QUIPU SHPK	420,000.00 €	420,000.00 €	Pranohet në teresi
10	The European Union	1,513,003.79 €		Nuk pranohet Përfundimi me datë 30.08.2024 pas Njoftimit për Kontratë.
X		19,296,485.20 €	6,682,536.54 €	

Grup i Operatorëve Ekonomik  
SH.P.K. Shupkocë, Mitrovicë

TEHNOBURIMI D.D.; EURO - BESI

14,606,109.05 €

**ARSYETIM I ELIMINIMIT:**

Grup i Operatorëve Ekonomik TEHNOBURIMI D.D.; EURO - BESI SH.P.K.: nuk e plotëson kriterin - Kërkesa 1.3. Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për punë ndërtimore për zbatimin e projekteve të hollësishme [zbatuese kryesore]- të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e ndërtesave publike shoqërore [sipas kuptimit të paraqitur në vijim], në shumën prej 15,000,000.00 € [Pesëmbëdhjetë milion euro]. Pasi që i njëjti bazuar në dokumentacionin e bashkangjitur dhe tabelën e hartuar nga ana e tij i ka paraqitur projektet në zbatim dhe ato që janë zbatuar për gjatë tre viteve të shkuara dhe të cilët nuk e plotësojnë kriterin prej 15 milionë Euro / pasi që i njëjti në të gjitha projektet ka pranuar të përfundim dhe jo vlerën totale, si dhe shumica e projekteve të paraqitura janë të natyrës furnizime.

1. Referenca e Comodita Home – Gjakovë / ka datën e referencës me datë 15.11.2022 (ndërsa në fund të referencës theksohet se punët kanë përfunduar 03.11.2023 / Një vit pasi që kjo Letër Reference është hartuar).

2. Referenca për kompaninë GEKOS / e njëjta nuk ka datë të lëshimit mirëpo vetëm date të fillimit të punimeve.

3. Referenca e kompanisë VIVA FRESH SHPK / – TehnoBurimi e njëjta nuk ka datë të lëshimit mirëpo vetëm date të fillimit të punimeve.

4. Kontrata objektet Interex Kline (nuk është e nënshkruar nga ana e punëdhënësit), Istog, American Retail Park, Peje, e paqarte për të gjitha lotët, është furnizim dhe ka mospërputhje vlerash, leter rekomandimi nuk ka date

5. Objekti për fabrike të bllokove, në letër rekomandim paraqitet vetëm si kontrate furnizimi, referenca nuk ka date, d.m.th. datat janë të paraqitura vetëm sipas kontratave, jo në referencë, d.m.th. kontrata ka të bëjë me furnizim.

I njëjti Grup nuk e ka vazhduar Validitetin e Ofertave sipas Kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Grup i Operatorëve Ekonomik <b>AKTIV RESIDENCE SH.P.K.; VLLEZËRIT ASLLANI SH.P.K.; AKTIV SH.P.K.</b> Rruga Jasharajve, Nr.27, Glllogoc	14,733,566.03
--	---------------

**ARSYETIM I ELIMINIMIT:**

Grup i Operatorëve Ekonomik **AKTIV RESIDENCE SH.P.K.; VLLEZËRIT ASLLANI SH.P.K.; AKTIV SH.P.K.**: nuk e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktues lidhur me aspektin e Referencave të natyrës së ngjashme pasi që projekti numër 2 në listën e paraqitur nga ana e kompanisë Vëllezërit Asllani në vlerë financiare 3012595.02 Euro ka Certifikatë përfundimtare të punimeve të lëshuar me datë 31.05.2021 dhe se kjo kohë është me e gjatë se sa kërkesa e Autoritetit Kontraktues ku specifikohet: dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt bazuar në Ligjin për Prokurim Publik neni 69 thekson se Referencat ndërlidhen me kohë 3 vite prej publikimit të Njoftimit për Kontratë ndërsa procedura e Stadiumit të Gjilanit është ngritur në platforme me datë 29.08.2024 / me shume se 3 vite nga kjo reference. Në rastin kur AK nuk e llogarite këtë reference vlera e kontratave të prezantuara është me e ulët se sa vlera e kërkesës së AK (respektivisht janë kërkuar 15 milionë euro ndërsa janë paraqitur: 13705335.35 Euro). Gjithashtu Aktiv shpk nuk ka të dorëzuar fare për asnjë vit raport të auditimit, ndërsa Aktiv Rezidencë mungon raporti i auditimit për vitin 2021 (por mund të kërkohej bazuar në nenin 72).

Grup i Operatorëve Ekonomik <b>ARDA REI Group SH.P.K.; Fabrika Karposh A.D.</b> Skopje Bulevardi Bill Clinton, Zona Industriale p.n., Prishtine	14,822,879.28 €
---	-----------------

#### ARSYETIM I ELIMINIMIT:

1. Nuk plotësohet ky kriteri pasi që nga Banka shkruan: HalkBank Ad Skopje është e gatshme të miratojë mbështetje kreditore për Fabrika Karpos AD Skopje pas aplikimit për kredi në shumën Euro 2000000 nëse në momentin e paraqitjes së kërkesës plotësohen kriteret e politikave dhe procedurave kreditore. Pra i njëjti nuk ka para te gatshme por as aprovim te kreditës

2. Nuk e plotëson kete kriter pasi që i njëjti projektin Construction of a residential building of the Second Category "ATRIA" (P+6+PK) in city quarter S3 18 BLOCK 7, GP 7.2 on Newly designed streets "6" and "7" of KP no. 6508, CP no. 6509/2 and CP no. 6507/3, KO Gjorche Petrov 4 – Vllae, in the municipality of Gjorche Petrov e ka te realizuar me datë 02.2021 dhe i bije se eshte me i hershem se sa tri vitet paraprake. / Bazuar ne raportin e paraqitur ka referenca vetem: 10929400.00 nga Fabrika ndersa nga Arda Rei plus: 2120000 Euro / Total: 13049400.00 ndersa AK ka kerkuar 15 milione. Sqarim ky projekt: Completion date of the implementation of the Construction Works Contract [month/ year]: 02.2021. Bazuar në pranimin teknik pozitiv nga mbikëqyrja e kryer në datën 08.02.2021, kjo certifikatë i lëshohet kontraktorit të punimeve të ndërtimit dhe artizanatit për performancë cilësore dhe në kohë, të cilat do të shërbejnë si dëshmi për pjesëmarrje të mëtejshme në tendera

3. Nuk e plotëson piken b. b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; (i njëjti nuk e ka deklaratën nga secili anëtar vec e vec).

4. Paramasa te instalimet e makinerise M1.20 Izolimi per tubacion te bakrit per gas S-13mm nuk ka te vendosur çmim dhe si e tille oferta eshte e papergjegjshme.

I njëjti grup nuk e ka vazhduar Validitetin e Ofertave sipas Kërkesës se Autoritetit Kontraktues.

**Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerr me dt.20.03.2025, ku është refuzuar kërkesa për rishqyrtim si e pabazuar.**

**Në lidhje me arsyen e eliminimit tonë, AK-së është përgjigjur si në vijim:**

Sqarim Zyra e Prokurimit juve nuk ju ka eliminuar / mirëpo ju ka eliminuar aspekti që dokumentacioni i juaj nuk është hapur pasi që kur lënda është pezulluar ju keni vazhduar plotësimin e dokumentacionit mbi ofertën e krijuar para pezullimit dhe i gjithë dokumentacioni i juaj është dekriptuar dhe i njëjti nuk mund të hapet (pasi që me shkuarjen e lëndës në apel) krijohen çelësa të ri te hapjes dhe dokumentacioni paraprak nuk vlenë.

Kjo çështje është e vërtetuar edhe nga KRPP HelpDesk / Tavolina ndihmese dhe Departamenti i Teknologjise se Informacionit ku ofertën tuaj dhe te Alba Group SHPK / i ka klasifikuar që nuk mund të hapen nën arsyetimet e më poshtme.

Në kete formë ju totalisht jeni pa interes material dhe se dokumentacioni i juaj është i pavlefshëm, respektivisht i gjithë dokumentacioni i pa pranueshëm.

Sqarim, nuk jeni eliminuar pa arsyeje, mirëpo jeni eliminuar me arsyetimet e KRPP-se.

Arsyeja e AK-së se zyra e prokurimit nuk na ka eliminuar është absurde, pasi që dihet se vlerësimi i ofertave bëhet nga komisioni vlerësues dhe se raportin e komisionit në fund e nënshkruan ZPP nëse konsideron se është vlerësuar drejtë, ndërsa ka kompetenca që edhe mos të aprovojë rekomandimin e komisionit vlerësues nëse mendon se nuk janë vlerësuar drejtë ofertat.

Arsyeja e AK-së se dokumentacioni është dekriptuar dhe i njëjti nuk mund të hapet, pasi që me shkuarjen e lëndës në apel, krijohen çelësat e ri të hapjes dhe dokumentacioni paraprak nuk vlen, është arsye e pa bazuar dhe e paqëndrueshme sepse askund në LPP e as në legjislacionin sekondar nuk është i cekur ky konstatim i KRPP-së, prandaj ne si OE nuk

duhet të pësojmë dhe të eliminohe mi për ndonjë rregull apo parim i cili nuk është pjesë e legjislacionit apo pjesë e ndonjë rregulloreje apo udhëzimi administrativ.

Realisht arsyeja e eliminimit bie në kundërshtim edhe me nenin 56.3 të LPP-së.

Ne e kemi ngrit në sistem tërë dokumentacionin dhe kjo dëshmohe t qartë, ndërsa përse nuk hapen dokumentet ne nuk jemi fajtor e as që duhet të diskriminohe mi në këtë rast.

Në lidhje me pretendimin tonë për shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP-së, autoriteti kontraktues pretendon se është shkelje ligjore nëse jepet dokumentacioni i OE kur është plotësuar aneksi 3 dhe kur është arsyetuar kërkesa për sekret afarist, mirëpo AK-së i shmanget realitetit që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret dhe bindës se zbulimi i dokumenteve do at dëmtonte interesin e kompanisë në fjalë.

Arsyetimi i AK-së është mjaft qesharak kur pretendon se plani dinamik na është dhënë neve pavarësisht që bënë pjesë në nenin 69 të LPP-së dhe kinse është respektuar qasja në dokumente.

Në lidhje me pretendimin ankimor përkitazi me vërtetimin e ATK-së për OE e rekomanduar për kontratë, AK-së është përgjigjur si më poshtë:

**Përgjigje- Pretendimi ankimor 3:**

- Pretendimi ankimor 3 refuzohet, me arsyetimin:

Paraqesim se Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë ka paraqitur një dokument të ATK-se të datës 06.02.2025 kohë kjo valide pasi qe dokumenti i paraqitur nga ATK precizon vlefshmëri 90 ditë dhe se AK ka dal me rezultat me datë 13.03.2025. Përderisa ka marrëveshje me ATK i njëjti llogaritet si Operator qe ka te drejtën e operimit ne sektorin publik dhe ne asnjë dispozite ligjore kjo çëshje nuk ju ndalohet.

Për këtë pretendim ne nuk kemi pranuar përgjigje të drejtpërdrejtë por kemi shmangie nga pyetja që është bërë, e që me siguri mund të ketë ndonjë pengesë për të qenë fitues OE i rekomanduar për kontratë, pasi që nuk po jepet përgjigja konkrete në lidhje me marrëveshjen për borxhe dhe se kur është bërë kjo marrëveshje. Thjesht neve na ka interesuar të dimë se marrëveshja për shlyerjen e borxheve a është nënshkruar para datë së njoftimit për kontratë apo pas datës së njoftimit për kontratë. Edhe nga kjo përgjigje, neve na shtohen dyshimet edhe më shumë në artë që marrëveshja për shlyerjen e borxheve është e datës pas njoftimit për kontratë e nëse veç është kështu atëherë OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Në lidhje me pretendimin ankimor përkitazi me vërtetimin nga Banka, AK-së është përgjigjur si më poshtë:

**Përgjigje- Pretendimi ankimor 4:**

- Pretendimi ankimor 4 refuzohet, me arsyetimin:

Aspektin e qasjes ne bank, i njëjti ka të paraqitur dokument ku thekson qe ka të aprovuar 4.4 milionë Euro dhe se te njëjtat mund të shfrytëzohen për aspektin e procedurës në fjalë.

Kjo përgjigje është abstrakte sepse ne nuk kemi pa një dokument të tillë dhe përsëri nuk mund të besojmë që ky dokument është i rregullt dhe që plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Në lidhje me pretendimin ankimor përkitazi me atë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriterin e kontratave dhe referencave në vlerën e kërkuar, AK-së është përgjigjur duke thënë se vlera e kontratave tani e OE të rekomanduar për kontratë është rreth 30 milion euro, e po ashtu duke sqaruar kinse kontrata me Unops është përfunduar në vitin 2024.

Në përgjigje ndër të tjera AK-së ka sqaruar si në vijim:

**Shënim me rendësi:**

Komisioni vlerësues sipas kompetencave që kishte, duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit, konkretisht në nenin 59 dhe 72 të Ligjit të Prokurimit të Kosovës dhe sipas nenit 69 pika 2, 2.1 (ii) lidhur me referencat e sektorit privat, i ka kërkuar sqarime Operatorit Ekonomik të shpërblyer me kontratë që të arsyetoi të gjitha referencat e natyrës së ngjashme në sektorin privat duke i kërkuar si vijon:

*“Per Projektet e paraqitura në listë dhe në aneksin 1, (kontratat) të lidhura nga ana e juaj dhe kompanive private ju keni dorëzuar kontrate dhe reference mirepo për dallim nga kontratat shëterore që njafton Referenca / projektet që lidhen me sektorin privat duhet të deshmohen edhe përmes transaksioneve bankare. Kështu që ju duhet të bashkëngjisni transaksionet bankare, dhe dokument tjetër deshmues (faturat) për vlerat e paraqitura sipas listës së kontratave, dhe aneksit 1”.*

OE në kthimin e kërkesës të paraqitur nga AK me datë 30.01.2025 / brenda afatit kohor ka arritur të paraqesë dëshmi dhe kompetencë se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme ku i ka vërtetuar me raporte të pranimit teknik kontrata, referenca dhe për të gjitha referencat e sektorit privat i njëjti ka paraqitur dokumentacion si: Faturat e nënshkruara, të nënshkruara e vëlosura nga blerësi, e të gjitha këto të vërtetuar me Libra të Shitjes dhe me Konfirmime apo transaksione të pagesave. I njëjti operator ekonomik për secilën referencë ka paraqitur edhe nga një raport në mes transaksioneve bankare dhe faturimit nga ana e tij.

Të gjitha faturat e paraqitura nga ana e Operatorit Ekonomik janë fatura të Realizimit të punimeve sipas kontratave realizimi i punëve në objektin përkatës dhe të ngjashme. Për secilin nga projektet i njëjti e ka paraqitur me arsyetime se cilat punë janë kryer, duke paraqitur fotografi gjatë realizimit të punëve dhe fotografi të objekteve të realizuara dhe se komisioni vlerësues ka klasifikuar se i gjithë dokumentacioni është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Edhe për këto sqarime, ne nuk kemi asnjë dëshmi konkrete për tu bindur se e vërteta është siç e paraqet AK-së, prandaj përderisa nuk kemi dëshmi, ne i kemi dyshimet tona që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për këtë arsye.

Nga këto dëshmi që u cekën më lartë rezulton se ne jemi eliminuar padrejtësisht dhe po ashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, e po ashtu edhe OE tjerë ofertues janë të papërgjegjshëm, prandaj ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë sipas nenit 59 të LPP-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet e lartcekura kuptohet që nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse është i papërgjegjshëm, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.*

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

### VENDIM

**APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE **Raf II SHPK**

**ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 5,000.00 euro.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.



THE UNIVERSITY OF CHICAGO

1961

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

THE UNIVERSITY OF CHICAGO

